

## **Pro Bono – Shërbime ligjore falas**

Ne ofrojmë shërbime ligjore falas në interes publik (pro bono) për një gamë të gjerë klientësh, nga azilkërkues individualë, gazetarë, media, organizata jofitimprurëse, bamirësi deri te disa individë me të ardhura të ulëta ose me status të paaftësisë së përkohshme.

Ne besojmë se të gjithë duhet të kenë akses efektiv në të drejtat e tyre ligjore dhe përqendrojmë përpjekjet tona në promovimin e aksesit në të drejtat e grupeve tona të synuara, duke përfshirë gratë, fëmijët, të mbijetuarit e trafikimit dhe refugjatët.

Qëllimi ynë është të kemi ndikimin e mundshëm në aksesin në drejtësi dhe aksesin në mundësi, përmes marrëdhënieve me klientët tanë të vazhdueshëm pro bono dhe duke i mbështetur ata në mënyrë proaktive në adresimin e çështjeve sistemike. Klientët tanë pro bono janë klientë të firmës: ne nuk bëjmë dallim të brendshëm midis punës së paguar dhe pro bono.

## **Avokatët “Pro bono” në Shqipëri**

Në Shqipëri, në nenin 54, pika 4, të ligjit nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se dhënia e shërbimeve të avokatisë “pro bono” njihet si kredit në përmbushjen e detyrimit për trajnimin vazhdues. Kjo dispozitë blanket na referon tek Statuti i Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë dhe Rregullorja e Shkollës së Avokatisë. Sipas ligjit, rregulla të hollësishme për organizimin, pjesëmarrjen dhe mënyrën e zhvillimit të trajnimit vazhdues, si dhe për njësimin e shërbimeve “pro bono” në kredite për trajnimin vazhdues përcaktohen në Statutin e Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë dhe në Rregulloren e Shkollës së Avokatisë.

Si avokatë, ne kemi një pozitë të privilegjuar në shoqëri. Ky privilegj është aftësia për të ofruar këshilla ligjore dhe përfaqësim gjyqësor, aftësi të cilën nuk mund ta zotërojnë të gjithë. Me këtë privilegj vijnë edhe përgjegjësi, siç janë sigurimi i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe kontributi në administrimin e drejtësisë. Duke qenë se avokatët janë mbrojtës të të drejtave ligjore të qytetarëve, atëherë kjo ndihmë dhe kjo mbrojtje duhet të ofrohet për të gjithë njerëzit, pavarësisht rrethanave të tyre financiare apo individuale.

Gjithashtu, ekziston një detyrim moral për një përkushtim ndaj punës pa shpërblim “pro bono”, pasi si avokatë ne kemi kapacitetin për të ndihmuar njerëzit në një mënyrë që mund t’u ndryshojë atyre jetën.

Prandaj roli i avokatëve “pro bono”, të cilët kanë aftësi ligjore dhe eksperiencë, është shumë i rëndësishëm, pasi është një mundësi për një përfaqësim ligjor sa cilësor aq edhe dinjitos edhe për kategoritë në nevojë.

“Pro bono” është shkurtim i frazës latine “pro bono publico”, që do të thotë “për të mirën publike”. Termi në përgjithësi i referohet shërbimeve që ofrohen nga një profesionist falas. Ofruesi jep një shërbim në dobi të komunitetit, në vend që të punojë për fitim.

## **Llojet e avokatëve**

Një nga vendimet që duhet të marrë një individ që përballet me drejtësinë është zgjedhja nëse do të punësojë një avokat privat, do të kërkojë një avokat të caktuar nga gjykata, ose të pranojë ndihmën “pro bono” të një avokati.

Ka ndryshime midis një avokati të caktuar nga gjykata, një avokati “pro bono” dhe një avokati që ju zgjidhni privatisht.

Avokatët e caktuar nga gjykata janë avokatët që e ndjekin çështjen pa kosto për individin, por kundrejt punës së tyre përfitojnë një pagesë nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas. Për të përfituar ndihmën e një avokati të caktuar nga gjykata, individit duhet të plotësojë kritere specifike. Avokatët e caktuar nga gjykata ose ndihma juridike falas i referohet një grupi avokatësh që punojnë ekskluzivisht për klientët që kualifikohen për shërbimet e tyre - klientë me të ardhura të pamjaftueshme ose kategori të veçanta.

Ndërsa avokati “pro bono” pranon të marrë përsipër një çështje, pa kosto për individin dhe shtetin. “Pro bono” është një term latin që i referohet punës që një avokat bën falas. Të gjithë avokatët inkurajohen t'i kushtojnë një pjesë të kohës së tyre përfaqësimit vullnetar të kategorive që nuk do të kishin akses

### **Aplikoni për ndihmë juridike falas Pro Bono**

Ndihma Juridike siguron drejtësi, barazi dhe akses në mundësi për dhe me njerëzit që kanë të ardhura të ulëta përmes përfaqësimit ligjor për ju.

#### **Kam nevojë për ndihmë? Ndiqni hapat e mëposhtëm:**

Ju mund të aplikoni për ndihmë Pro Bono në mënyrë të sigurt duke u paraqitur personalisht pranë zyrës sonë ose duke na shkruar direkt online në faqen tonë të internetit 24/7. Ju lutemi kliko [këtu](#) për të aplikuar online!

Kërkesa për Aplikim online merr rreth 15 minuta për të përfunduar. Ju mund të na shkruani në shqip ose në anglisht.

Pasi të plotësoni të gjitha të dhënat e kërkuara në formën e kontaktit, ju lutemi dërgojeni atë.

Ju lutemi, vini re se pas paraqitjes së kërkesës, kjo do të kërkojë një kohë për të marrë një përgjigje nga Frashëri Firm për të përfunduar procesin e pranimit. Ju do të merrni një përgjigje ose telefonatë nga Frashëri Law Firm brenda 3 ditëve të punës.

Me miratimin e kërkesës, ju duhet të paraqiteni personalisht pranë zyrës sonë për të nënshkruar Marrëveshje Tip për Shërbimin Ligjor “Pro bono”.